

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS “ART PAMOR AMU”**



Program orientues

**Koordinator:
Marina Topulli**

2025-2026

TABELA E PËRMBAJTJES


TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	6
Modele të pyetjeve për nivelin arsimor AMU	14
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	20
Model ore mësimore për nivelin AMU “ART PAMOR”.....	21
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	37
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU	39
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU	45

HYRJJE

Roli i mësuesit shtrihet përtej mësimdhënies dhe në veçanti roli i mësuesit i artit pamor artit është edhe më i rëndësishëm për shkak të natyrës sfiduese të kësaj lënde. Ai ndikon në krijimin e një mjedisi pozitiv mësimor, zhvillimin e mendimit kritik dhe nxitjen e motivimit për të mësuar. Mësuesit që përdorin teknika efektive mësimore, të bazuara në nevojat individuale të nxënësve, arrijnë të maksimizojnë potencialin e çdo nxënësi. Një marrëdhënie e mirë mes mësuesit dhe nxënësit krijon një ndjenjë sigurie dhe përkatësie që rrit motivimin dhe angazhimin në mësim. Mësuesit që janë të aftë të identifikojnë vështirësitë individuale dhe t'u japin mbështetje të personalizuar nxënësve, ndikojnë ndjeshëm në arritjet e tyre akademike. Mësuesit shpesh janë shembuj për nxënësit, duke ndikuar jo vetëm në njohuritë mësimore, por edhe në vlerat dhe sjelljet që ata përvetësojnë.

Arti pamor synon drejt formimit të nxënësit nëpërmjet integritit dhe transmetimit të njohurive për të zhvilluar tek ata aftësi të një formimi personal dhe artistik, duke i dhënë vëmendje procesit real të edukimit artistik si dhe duke e vendosur nxënësin në qendër të këtij procesi. Mësuesi i artit pamor është një udhërrëfyes në orientimin, në thellimin dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive për të maturuar kompetencat themelore, duke krijuar në këtë mënyrë një vijueshmëri logjike të formimit të nxënësve përmes një metodologjie në të gjitha hallkat e tematikave dhe vlerësimin në përfundim të tyre.

Arti pamor kërkon të menduarit krijues dhe artistik, por edhe kritik për zgjidhjen e problemeve dhe analizimin e situatave komplekse artistike. Një mësues i aftë mund t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të menduar logjikisht dhe për të zbërthyer problemet në hapa të qartë. Mësuesi duhet të jetë i aftë të përdorë metoda të ndryshme për të shpjeguar konceptet e vështira. Kjo mund të përfshijë përdorimin e mjeteve vizuale, shembujve/modeleve realë, zbatimit të aftësive në jetën reale që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet figurative. Arti pamor ndërtohet mbi konceptet e mëparshme, ndaj një mësues i mirë i artit pamor e di se duhet të fillojë nga bazat dhe të krijojë një strukturë logjike për të avancuar me koncepte më të përparuara. Kjo siguron që nxënësit të kenë një themel të fortë dhe të mos ndihen të mbingarkuar. Një mësues i mirë i artit pamor mund të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në fusha të caktuara dhe të japë mbështetje shtesë për ta.



Shpesh arti pamor shihet si fushë që duhet të zhvillohet vetëm me nxënësit e talentuar. Mësuesi duhet të krijojë veprimtari dhe sfida që nxisin kureshtjen e nxënësve, duke e lidhur artin figurativ me situata praktike nga jeta e përditshme ose me fushat që ata i pëlqejnë. Mësuesi i artit pamor mund të përfitojë nga përdorimi i programeve kompjuterike, aplikacioneve dhe platformave të ndryshme artistike që ndihmojnë nxënësit të praktikojnë konceptet dhe të zgjidhin vështirësitë me artin figurativ.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve në degën e artit figurativ është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së artit pamor për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë njohuritë artistike pamore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike,



antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndergjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

- **Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar.** Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e artit pamor në nivelin arsimor: *arsim i mesëm i ulët (AMU)*.
- **Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur.** Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, dy modele orësh mësimore për lëndën e artit pamor në nivelin arsimor: *arsim i mesëm i ulët (AMU)* si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.
- **Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular.** Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projektesh kurrikulare për lëndën e artit pamor në nivelin arsimor: *arsim i mesëm i ulët (AMU)* si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Programe lëndore të artit pamor ;

- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënies – nxënies të programit për lëndën e artit pamor;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programit për lëndën e artit pamor.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale artistike si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të programit për lëndën e artit pamor.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE “ART PAMOR”	
Kompetenca	
“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të artit pamor në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e	• Korniza Kurrikulare. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX. • Programi artit pamor me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX.

koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, tematikash, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të artit pamor); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e artit pamor me shkencat e tjera dhe me jetën reale.	
---	--

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësime të artit pamor ”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i artit pamor:

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS.

- demonstron përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstron respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikon nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; - demonstron qëndrim pozitiv ndaj lëndës së artit pamor; - edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkshërinë ndaj lëndës së artit pamor; - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të ulët, 2023.
---	--

Kompetenca II

“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e artit pamor”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i artit pamor:

- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë), ASCAP.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të ulët.

• përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor proceset artistike në mësimdhënien – nxënien e artit pamor; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmblendhëse.	
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies, në artin pamor”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> • prezanton materiale të ndryshme, duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, design, etj; • nxiti nxënësit të bëjnë prezantime në art pamor duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënien – nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së artit pamor apo në projekte	Literatura e rekomanduar • Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. • Udhëzues për mësimin e artit pamor (për klasat VI-IX të arsimit të mesëm të ulët) (modele orësh mësimore dhe veprimtari praktike) ASCAP.

kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	Literatura
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”	
Kompetenca	
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	Literatura
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - njih rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; - demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca	
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e artit pamor”	Literatura e rekomanduar
Rezult <i>Mësuesi i artit pamor:</i> - dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e artit pamor në klasat VI-IX; - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve figurative në klasat VI-IX; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive;	Programe dhe tekste të lëndës së artit pamor për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët.

- 
- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• dallon ndërvarësinë e koncepteve figurative nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;• zhvillon me kreativitet mënyra të ndryshme të zhvillimit të veprimtarive artistike të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve VI-IX;• mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të artit pamor me artet e tjera dhe me shkencat e tjera dhe në jetën e përditshme. | |
|---|--|

Modele të pyetjeve për nivelin arsimor AMU

Model pyetjesh lënda: “Art pamor” AMU

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Përdorimi i mjeteve mësimore dhe përzgjedhja e tyre nga ana e mësuesit, NUK ndihmon në:

- A) Zhvillimin e planit të aktiviteteve gjatë procesit mësimor.
- B) Zbatimin e programit mësimor lëndor.
- C) Përgatitjen e planifikimit ditor.
- D) Menaxhimin e nxënësve.

Pyetja 2

Programi i artit pamor ka në thelbin e tij, krijimin e kushteve për ndërtimin e:

- A) (2) kompetencave lëndore;
- B) (3) kompetencave lëndore;
- C) (4) kompetencave lëndore;
- D) (5) kompetencave lëndore.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetje 3

Cilës prej niveleve të arritjeve i përket rezultati i të nxënit: “Shpjegon karakteristikat e Artit Barok”?

- A) NIVELI 0 (nota 4)
- B) NIVELI I (nota 5-6)
- C) NIVELI II (nota 7-8)
- D) NIVELI III (nota 9-10)

Pyetje 4

Përmbajtja e pyetjes.

Sipas taksonomisë së Blumit, tre fushat e të nxënit janë:

- A) Krijuese, vlerësuese, vepruese.
- B) Analizuese, sintetizuese, vlerësuese.
- C) Njohëse, vlerësuese, krijuese.
- D) Njohëse, emocionale, psikomotore.

Pyetja 5

Metoda e demonstrimit është një metodë e përshtatshme për një nga temat mësimore si më poshtë:

- A) Theksi dhe qendra e interesit.
- B) Forma dydimensionale pozitive dhe negative.
- C) Gdhendja mbi sapun.
- D) Arti i realizmit socialist.

Pyetja 6

Rezultati i të nxënit: “Përshkruan elementet artistikë të veprës së artit” i përket:

- A) Nivelit njohës
- B) Nivelit zbatues
- C) Nivelit vlerësues
- D) Nivelit analizues

Pyetja 7

Procesi i kritikës në lëndën e artit pamor do të thotë:

- A) Të ndihmohet nxënësin të kapërcejë vështirësitë gjatë punës.
- B) Të ndihmohet nxënësin të flasë rreth punimit të tij.
- C) Të kritikosh detaje të veçanta të punimit të nxënësit.
- D) Të kritikosh një nxënës për detyrën e realizuar jo mirë.

Pyetja 8

Qarko përgjigjen e saktë.

Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet vlerësim formues dhe është:

- A) vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të të mësuarit;
- B) vlerësim që mbledh prova që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj;
- C) vlerësim që mbledh të dhëna për suksesin e orës së mësimi;
- D) vlerësim përmblendës që kryhet në fund të periudhës.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9

Mësuesi ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën?

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet
- C) nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- D) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.

Pyetja 10

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija.
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor.
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën.
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

Pyetja 12

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucion arsimor

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Lëvizja artistike Pop Art, i ka fillimet e saj në:

- A) Spanjë
- B) Britani
- C) Gjermani
- D) Francë

Pyetja 14

Format artistike që patën ndikim te impresionizmi ishin:

- A) Arti folklorik dhe fotografia.
- B) Arti japonez dhe fotografia.
- C) Fotografia dhe arti akademik.
- D) Arti kinez dhe arti japonez.

Pyetja 15

- Amfiteatri i Durrësit është ndërtuar në:
 - A) Periudhën paleokristiane.
 - B) Periudhën klasike.
 - C) Periudhën e pushtimit romak.
 - D) Periudhën bizantine.

Pyetja 16

Postimpresionistët ishin artistë të cilët:

- A) Krijuan stilin e artit abstrakt.
- B) U rebeluan kundër kufizimeve të impresionizmit.
- C) Ruajtën traditat artistike të impresionistëve.
- D) Patën pak ndikim në artin e shek. XX.

Pyetja 17

Profesioni që merret me nxjerrjen në dritë të dëshmive materiale të kohës së shkuar :

- A) Kurator
- B) Arkeolog
- C) Grafik dizajn
- D) Koleksionist

Pyetja 18

Vëzhgo veprën artistike dhe qarko kujt lëvizje artistike i përketë:

- A) Impresionizmi
- B) Abstraksionizmi
- C) Ekspresionizmi
- D) Fovizmi



Pyetja 19

Mozaiku në imazhin e mëposhtëm, i gjetur në Arapaj të Durrësit i përket:

- A) Periudhës helene.
- B) Periudhës romake.
- C) Periudhës paleokristiane.
- D) Periudhës bizantine.



Pyetja 20

Teknika e afreskut ka të bëjë me:

- A) Pikturimin mbi suvanë ende të freskët.
- B) Pikturimin mbi suvanë e thatë e të lëmuar.
- C) Përdorimin e ngjyrave të tretura në dyllë ose në recinë.
- D) Vendosjen e bojërave të zbutura mbi suvanë e thatë nëpërmjet spatulës.

Pyetja 21

Një ndër artistët e renditur më poshtë, nuk është skulptor:

- A) Odise Paskali
- B) Shaban Hadëri
- C) Kel Kodheli
- D) Andrea Mano

Pyetja 22

Një nga proceset e mëposhtme lidhet me teknikën e stampimit:

- A) Derdhja
- B) Gdhendja
- C) Thurja
- D) Modelimi

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përse i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat artistike, duhet të përvetësojnë konceptet artistike dhe të zotërojnë shprehitë mbi artin pamor. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënës dhe përshtaten me stilet e të nxënës dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxëni efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat artistike janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënës që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur dy modele orësh mësimore për artin pamor *AMU*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për nivelin AMU “ART PAMOR”

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënës, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

A. Model ore mësimore 1, lënda: Art pamor, AMU

Fusha: Arte	Lënda: Art Pamor	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Arti Egjiptian		Situata e të nxënës: Rëndësia e kulturës egjiptiane dhe ndikimi në historinë e artit.	
Rezultatet e të nxënës (bazuar në programin lëndor): <i>Nxënësi në fund të orës së mësim:</i> • përshkruan kanunin egjiptian të përmasave, në përcaktimin e proporcioneve të figurës së njeriut; • ndërton figurën e njeriut sipas karakteristikave të pikturës dhe skulpturës në artin egjiptian; • diskuton periudhat historike dhe karakteristikat kryesore të artit egjiptian në arkitekturë, skulpturë, pikturë;		Fjalët kyçe: • piramida • mastaba • tempuj, • piktura dhe skulptura egjiptiane • hieroglifë	
Burimet: • teksti i nxënësit • imazhe që tregojnë rreth artit, arkitekturës dhe qytetërimit egjiptian.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Gjuha dhe komunikimi • Historia • Gjeografi • Tik	

Mjete: fletore vizatimi, laps. gomë, vizore, lapsa me ngjyra.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Organizimi i orës së mësimi:

Parashikimi i njohurive: Në projektor shfaqen imazhe të historis së Egjiptit në tri periudhat e tij të mëdha dhe imazhe nga arti egjiptian (arkitekturë, skulpturë, pikturë).

Mësuesi nxit nxënësit të kujtojnë:

- Ç’kujtoni nga periudhat historike të Egjiptit nga lënda e historisë?
- Pse kanë shërbyer piramidat? Cfarë materiali është përdorur për ndërtimin e tyre?
- Ç'mund të thoni për pikturën dhe skulpturën në artin egjiptian, pas imazheve që ndoqët në projektor?

Nga përgjigjet e nxënësve dhe diskutimi rreth imazheve të shfaqura në projektor plotësohet kllasteri:



Diskutim: Nxënësit japin shembuj të kllasterit..

Ndërtimi i njohurive: Nxënësit vëzhgojnë në projektor skemën e ndërtimit të figurës së njeriut, sipas kanunit të përmasave në artin egjiptian. Mësuesi shtron pyetje:

- Cilat janë disa nga përmasat standarde që u përdorën në krijimin e veprave të artit egjiptian?

- Çfarë është kanuni i përmasave në artin egjiptian? Si ndihmon në përcaktimin e proporcioneve të figurës së njeriut?
- Cilat ishin temat kryesore të artit egjiptian dhe si u shprehën ato?

Veprimtari: Në tabelë vendosen tre foto të printuara, ku paraqiten piktura të artit egjiptian me tematika të ndryshme.

Secili nxënës zgjedh për të riprodhuar në fletoren e vizatimit, pikturën që pëlqen dhe që ndjen të sigurtë se mund të realizojë.

- Cilët janë simbolet dhe elementët e ndryshëm të përdorur në këto piktura?
- Cilat janë ngjyrat e dominuara në pikturë?



Shpjegohen hapat e punës dhe mjetet që mund të përdoren për realizimin e secilit punim.

Përforcimi i të nxënit:

- Tabela e koncepteve dhe Diskutim :

Në përfundimin e punimeve të veprimtarisë, në klasë përzgjidhen disa punime nxënësish dhe vendosen në një pjesë të tabelës.

- Në gjysmën tjetër të tabelës 4 nxënës plotësojnë tabelën e koncepteve me njohuritë e fituara nga mësimi i ri:

ARTI EGJIPTIAN			
Periudhat	Arkitektura	Piktura	Skulptura


Vlerësimi: Teknikat e vlerësimit që përdoren gjatë kësaj ore janë: vlerësim me gojë (të pyeturit, diskutimi, prezantimi etj.), vlerësim përmes detyrave krijuese, vlerësim të nxënësit nga nxënësi, mënyra si formulohen konkluzionet.

Vlerësimi do të mbështetet mbi nivelet e arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në këtë temë:

Niveli 2: Dallon periudhat historike dhe karakteristikat e pikturës në artin egjiptian;

Niveli 3: Shpjegon si ndihmon kanuni i përmasave në artin egjiptian në përcaktimin e proporcioneve të figurës së njeriut;

- **Niveli 4:** Diskuton periudhat historike dhe karakteristikat kryesore të artit egjiptian në arkitekturë, skulpturë, pikturë;



Detyra: Sipas nevojave të nxënësve dhe stileve të të nxënit mësuesi jep udhëzimet për detyrat.

Krijo një projekt në format A3 rreth ndërtimit të piramidave, tempujve dhe monumenteve të famshëm.

Grumbullim informacioni në enciklopedi, botime historike, botime arti, kërkime në internet etj...

- *Cilat janë disa nga përmasat standarde që u përdorën në krijimin e veprave të artit egjiptian?*
- *Çfarë është kanuni i përmasave në artin egjiptian? Si ndihmon në përcaktimin e proporcioneve të figurës së njeriut?*
- *Cilat ishin temat kryesore të artit egjiptian dhe si u shprehën ato?*

B. Model ore mësimore 2 në lëndën e “Art Pamor” AMU

Fusha: Arte	Lënda: Art Pamor	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: Teknika e Kolazhit		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit (bazuar në programin lëndor): <i>Nxënësi në fund të orës së mësimi:</i> - eksperimenton me materiale te ndryshme për të përdorur artin si mjet për komunikimin e një mesazhi social. - analizon përparësitë dhe vështirësitë e metodave artistike. - reflekton mbi procesin e krijimit të kolazhit, duke diskutuar sfidat e hasura gjatë procesit krijues.		Fjalët kyçe: - kolazh - kompozim - kreativitet - teknikë - kreativitet	
Burimet: - Shembuj të kolazheve realizuar nga artistë të njohur. - Teksti i nxënësit Mjete: - revista dhe gazeta të vjetra; - bojëra akrilik ose temper; - letra dhe copa me tekstura të ndryshme; - gërshërë; - ngjitës;		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK - Gjuha dhe komunikimi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimi: Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe përmes një bashkëbisedimi.

Nxënësit janë të vendosur në tavolina me grupe pune.

Parashikimi i njohurive: Në projektor shfaqen imazhe të ndryshme nga punime me teknikën e kolazhit.

Pyetje për bashkëbisedim në klasë rreth imazheve:

- *Ju pëlqejnë këto krijime?*
- *Çfarë kanë të veçantë?*
- *Çfarë teknike është përdorur për krijimin e tyre? Po materialet e përdorura?*

A njihni ndonjë artist që përdor kolazhin në krijimet e tij?

Në klasë diskutohet rreth mendimeve dhe njohurive të nxënësve për teknikën.

- Keni realizuar ju ndonjëherë punim me këtë teknikë?

Ndërtimi i njohurive: Në projektor vendoset një material i realizuar në Power Point, ku shfaqen informacione për:

- prejardhja e fjalës “kolazh”;
- përdorimi i kolazhit në Arti modern;
- përdorimi teknikës nga artistë si Pablo Picasso dhe Georges Braque;
- karakteristikat e kolazhit dhe veçoritë e realizimit;

Kolazhi është një teknikë që inkurajon eksperimentimin dhe kreativitetin. Artistët eksperimentojnë shpesh me materiale të reja dhe mënyra të ndryshme të përdorimit të tyre.

- *Si do të realizonit ju një kolazh?*

Nxënësit janë porositur më parë, që të kenë me vete materiale të ndryshme.

Veprimtari në grup: Nxënësit ndahen në grupe me 3-4 anëtarë dhe secili grup zgjedh të përgatisë një punim me teknikën e kolazhit.

Detyra : Nxënësit përdorin teknikën e kolazhit për të përcjell një mesazh social (p.sh. mbi barazinë, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e kafshëve, mbrojtjen e mjedisit etj...).

Materialet: Fletë të mëdha të bardha, markera, revista dhe gazeta të vjetra, letra me ngjyra, copa etj...


Mësuesi monitoron punën e nxënësve, i ndihmon me teknikën e ngjitjes dhe i udhëzon për të zgjedhur materialet e duhura për idenë e tyre.

Përforcimi i të nxënit: Pasi nxënësit të përfundojnë punën e tyre, secili grup prezanton kolazhin përpara klasës. Nxënësve ju drejtohen pyetje:

- Çfarë teme zgjodhët për realizimin e kompozimit tuaj?
- Çfarë ju frymëzoi për punimin tuaj?
- Përse zgjodhët këto materiale?

Mësuesi inkurajon diskutimin mbi vështirësitë e hasura gjatë procesit të realizimit të punimit.

Në tabelë vizatohet diagrama e Venit:



- A mendoni se është më e lehtë apo më e vështirë të përdorësh kolazh në krahasim me vizatimin/pikturën apo mozaikun?
- Cilat veçori janë të përbashkëta mes këtyre teknikave, dhe cilat janë të veçanta?

Vlerësimi: Teknikat e vlerësimit që përdoren gjatë kësaj ore janë: vlerësim me gojë (të

pyeturit, diskutimi, prezantimi etj.) vlerësimi i punës në grup, vlerësim përmes detyrave krijuese, vetëvlerësim, vlerësim të nxënësit nga nxënësi, mënyra e formulimit të konkluzioneve.

Vlerësimi do të mbështetet mbi nivelet e arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në këto tema:

Niveli 2: Identifikon materialet dhe mjetet e nevojshme për krijimin e një kolazhi;

Niveli 3: Krijon kolazh duke përdorur mjetet e nevojshme për krijimin e tij;

Niveli 4 Reflekton mbi procesin e krijimit të kolazhit, duke diskutuar sfidat e hasuar gjatë procesit krijues;

Detyra: Sipas nevojave të nxënësve dhe stileve të të nxënës mësuesi jep udhëzimet për detyrat. Nxënësit përdorin programe të thjeshta grafike si Canva ose Pixlr për të krijuar kolazhe dixhitale, duke kombinuar imazhe nga interneti ose fotografi personale. Kjo u mëson atyre elementët bazë të dizajnit dixhital.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore:

- mbështetin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënës.	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
	Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënës (RN) nuk bazohen në programin lëndor. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënës. Pyetjet që janë planifikuar nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënës (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënës. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënës. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodatat dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënës dhe me stilet e të nxënës. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënës, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.

Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxëniet gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	<i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxëniet gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxëniet gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxëniet gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxëniet gjatë gjithë jetës.</i>
--	--	--	--	--

Mjedisi i të nxëniet (6 pikë)

Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë,	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, por jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe</i>
---	--	---	---	---

shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>t'u shprehur</i> <i>lirshëm.</i> <i>Gjatë orës së</i> <i>mësimit vetëm</i> <i>disa nxënës</i> <i>përfshihen në</i> <i>veprimtaritë e</i> <i>orës së</i> <i>mësimit për të</i> <i>shprehur</i> <i>mendimet e</i> <i>tyre.</i>	<i>Mësuesi ka</i> <i>krijuar një</i> <i>kulturë të nxëni,</i> <i>por jo të gjithë</i> <i>ndihen të</i> <i>suksesshëm dhe</i> <i>me besim e</i> <i>vlerësim për</i> <i>veten.</i>	<i>ka krijuar një</i> <i>kulturë të nxëni,</i> <i>por jo të gjithë</i> <i>ndihen të</i> <i>suksesshëm dhe</i> <i>me besim e</i> <i>vlerësim për</i> <i>veten.</i>	<i>janë tolerantë</i> <i>duke pranuar</i> <i>mendimin ndryshe.</i> <i>Mësuesi ka krijuar</i> <i>një kulturë të nxëni</i> <i>për të gjithë duke</i> <i>nxitur besimin dhe</i> <i>vlerësimin për</i> <i>veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>Mësuesi</i> <i>organizon</i> <i>orën e</i> <i>mësimit në</i> <i>mënyrë</i> <i>tradicionale, ku</i> <i>ku pak nxënës</i> <i>përfshihen.</i> <i>Vetëm disa</i> <i>nxënës nxiten</i> <i>të marrin</i> <i>pjesë në</i> <i>mësim, të</i> <i>tjerët nuk</i> <i>nxiten me</i> <i>detyra</i> <i>motivuese.</i> <i>Mësuesi nuk u</i> <i>kushton</i> <i>vëmendje të</i> <i>gjithëve</i>	<i>Mësuesi</i> <i>organizon orën e</i> <i>mësimit në</i> <i>mënyrë</i> <i>tradicionale, ku</i> <i>jo të gjithë</i> <i>nxënësit</i> <i>përfshihen dhe</i> <i>angazhohen.</i> <i>Vetëm disa</i> <i>nxënës nxiten të</i> <i>marrin pjesë në</i> <i>mësim dhe të</i> <i>ndërmarrin</i> <i>iniciativa. Ai u</i> <i>kushton</i> <i>vëmendje, por</i> <i>nuk i jep</i> <i>mundësi të</i> <i>gjithëve të</i>	<i>Mësuesi</i> <i>organizon orën e</i> <i>mësimit duke u</i> <i>kujdesur që të</i> <i>gjithë nxënësit të</i> <i>përfshihen dhe</i> <i>angazhohen, por</i> <i>nuk i nxit ata me</i> <i>detyra motivuese</i> <i>duke i lënë disi</i> <i>pasivë. Ai u</i> <i>kushton</i> <i>vëmendje kur ata</i> <i>shprehin</i> <i>mendimet e tyre,</i> <i>i dëgjon me</i> <i>vëmendje, por</i> <i>nuk u jep</i> <i>mundësi të</i> <i>gjithëve të</i>	<i>Mësuesi organizon</i> <i>orën e mësimit</i> <i>duke u kujdesur që</i> <i>të gjithë nxënësit</i> <i>të përfshihen dhe</i> <i>angazhohen me</i> <i>detyra motivuese</i> <i>dhe i nxit ata të</i> <i>ndërmarrin</i> <i>iniciativa. Ai u</i> <i>kushton vëmendje</i> <i>kur ata shprehin</i> <i>mendimet e tyre, i</i> <i>dëgjon me</i> <i>vëmendje dhe u jep</i> <i>përgjigje me</i> <i>kujdes.</i>

	<i>lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>marrin një përgjigje.</i>	<i>marrin një përgjigje.</i>	
Metodat mësimore (6 pikë)				
Mësuesi përdor metoda nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u përqendruar më së shumti te vetëm ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësimi përqendrohet më shumë te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehjet e të menduarit në</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi, duke u përqendruar më së shumti te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehjet e mendimit kritik.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>

	<i>mënyrë kritike.</i>			
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</i>

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit. Mësuesi</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor</i>
---	--	---	---	--

duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>vijim të nxënësit. Mësuesi e përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh</i>	<i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me</i>	<i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të</i>	<i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas</i>

nevojave të nxënësve.	<i>stilet e të nxënit apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>detyra të diferencuara.</i>	<i>diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>stileve të të nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nuk i angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te ata të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.
- Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tre periudhat.
- Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.
- Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.

- 
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
 - Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
 - Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
 - Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
 - Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU

A. Model 1 i një projekti kurrikular për nxënësit AMU

Tema e projektit: Skenografia dhe kostumografia e teatrit të kukullave.

Kohëzgjatja: 3 orë, (të planifikuara 1 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa: IX

Rezultatet e të nxënësit: Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi:

- Zbaton aftësitë artistike, krijuese për konceptimin dhe realizimin e skenës e kostumeve.
- Përshkruan rolin e skenografisë dhe kostumografisë nëpërmjet përvojës vizuale dhe artistike të shfaqjeve teatrale në jetë reale.
- Eksperimenton me mjete shprehese dhe teknika të ndryshme artistike për të materializuar iden në realizimin e skenografisë dhe kukullave.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Projektimi i skenës dhe elementeve vizuale që përbëjnë hapësirën e shfaqjes.
- Krijimi i kostumeve të përshtatshme për karakteret e teatrit të kukullave.
- Lloji i teatrit ku aktorët janë kukulla dhe skenografia luan një rol të rëndësishëm në tregimin e historisë.
- Përdorimi i ngjyrave, materialeve dhe formave për të krijuar një atmosferë unike.

Partnerët:

- Mësuesi i artit pamor
- Mësuesi i letërsisë
- Profesionist të teatrit të kukullave

Burimet kryesore të informacionit: Libra dhe enciklopedi, video teatrale, dokumentar, intervista, pyetësorë, materiale nga interneti.

Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

 **Ora e parë:** Prezantimi i temës së projektit dhe fillimi i krijimit të konceptit të skenografisë dhe kostumografisë.

- Diskutimi rreth elementeve të skenografisë dhe kostumografisë në teatrin e kukullave.
- Bashkëpunim në grupe për të zgjedhur një skenar të shkurtër për shfaqjen e tyre të kukullave.
- Fillimi i hedhjes së ideve rreth krijimit të skicave për skenografinë dhe kostumet.

 **Ora e dytë:** Zhvillimi i detajeve të skenografisë dhe kostumografisë duke u bazuar në burimet e informacionit.

- Punë praktike për ndërtimin e mini-skenave dhe kostumeve, duke përdorur materiale të thjeshta.
- Krijimi i kukullave për të shoqëruar kostumet dhe skenat.

 **Ora e tretë:** Përfundimi dhe prezantimi i produktit përfundimtar.

- Nxënësit përfundojnë maketin e skenës dhe kostumet e kukullave me materiale të ndryshme.
- Secili grup prezanton përpara klasës detajet e projektit të realizuar duke përfunduar me një shfaqje të vogël në maketin e skenografisë me kostumet e kukullave të krijuara.

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Hulumtim dhe diskutim mbi konceptin e skenografisë dhe kostumografisë. Ndarja e klasës në grupe 5-6 nxënës.
- Grumbullim i informacionit nga literaturë e shkruar, intervista me profesionistë të fushës, kërkime në internet, ndjekja në youtube e shfaqjeve teatrale etj...
- Hartimi i projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale. Paraqitjet e duhura për të theksuar modelet, prirjet ose marrëdhëniet në të dhëna.
- Krijimi praktik i skenave dhe kostumeve me materiale të thjeshta dhe të riciklueshme.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit. Shfaqje të vogla të teatrit të kukullave duke përdorur produktet e krijuara.



Përshkrimi i produktit të projektit:

- ***Maketi i skenës dhe kostumet e kukullave:*** Nxënësit do të krijojnë një mini-skenë për një shfaqje të kukullave dhe do të dizajnojnë kostume për karakteret e tyre.
- ***Prezantim:*** Grupi do të performojë një shfaqje të shkurtër të teatrit të kukullave, duke demonstruar elementet e skenografisë dhe kostumografisë që kanë krijuar.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit, procesi i krijimit, vlerësimi i aftësive krijuese dhe bashkëpunimi në grup.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Vlerësimi përfundimtar i skenës dhe kostumeve për krijimtari, përshtatshmëri me veprën e përzgjedhur dhe përmbajtjen estetike.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit dhe çfarë është mësuar rreth procesit të skenografisë dhe kostumografisë në ndikimin e tyre në teatrin e kukullave

B. Model 2 i një projekti kurrikular për nxënësit, AMU

Tema e projektit: Rikonstruksioni i kalave në Shqipëri.

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 3 orë (të planifikuara 1 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa VI.

Rezultatet e të nxënit:

- Kërkon informacion rreth historisë së kalave kryesore në Shqipëri dhe rëndësinë e tyre kulturore e historike.
- Përshkruan konceptet arkitekturore të ndërtimit të kalave dhe funksionet mbrojtëse të tyre.
- Zhvillon aftësi krijuese dhe teknike për ndërtimin e modeleve të thjeshta të kalave.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- Arkitektura e ndërtimeve dhe karakteristikat e kalave.
- Funksioni i kalave në periudha të ndryshme historike.
- Kalatë në Shqipëri dhe roli i tyre në historinë e vendit tonë.
- Konstruksioni si janë ndërtuar kalatë, materialet e përdorura dhe teknikat arkitektonike të asaj kohe.

Partnerët:

- Mësuesi i lëndës së Artit Pamor
- Mësuesi i lëndës së Historisë
- Specialistë të trashëgimisë kulturore

Burimet kryesore të informacionit:

- Teksti i nxënësit;
- Informacioni i marrë nga interneti (kërkim mbi historikun, funksionin, materialet);
- Artikuj ose dokumentar;

- Informacion i marrë nga libra, albume dhe revista arti;

Baza materiale:

- Karton amballazhi ose me ngjyra;
- Shkumë ose allçi;
- ristela ose copa druri;
- plastelin ose argjilë etj...

Prezantimi i produktit sipas orëve të planifikuara:

📁 **Ora 1:** Prezantimi i temës së projektit dhe fillimi i mbledhjes së informacionit mbi kalatë kryesore në Shqipëri.

- Diskutimi rreth funksioneve dhe karakteristikave të kalave.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup zgjedh një kala për të hulumtuar.

📁 **Ora 2:** Zhvillimi i skic idesë dhe fillimi i ndërtimit të modelit të kalave.

- Nxënësit fillojnë të krijojnë modelin e kalas duke u bazuar në informacionin e përzgjedhur dhe skicat e përgatitura.
- Përzgjedhin materialet për ndërtimin e elementeve kryesore të kalave si muret e gurtë, strukturën e kullave dhe hyrjet.
- Përgatitja e prezantimit në formën e një albumi, duke përfshirë foto, detajet historike dhe funksionale të kalave.

📁 **Ora 3:** Përfundimi dhe prezantimi i modeleve të kalave.

- Secili grup përfundon ndërtimin e modeleve të kalave me materiale të ndryshme dhe bëjnë rregullimet përfundimtare.
- Prezantimi i projekteve tredimensionale të kalave përpara klasës, duke treguar për veçoritë arkitekturore, rëndësinë historike dhe funksionet mbrojtëse të kalave. Pjesë të prezantimit të gjithë antarët e secilit grup.



Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Informim mbi kalatë e Shqipërisë, zgjedhja e secilit grup një kala, krijimi i skicave fillestare.
- Prezantim në formën e një albumi, duke përfshirë foto, detajet historike dhe funksionale të kalave.
- Ndërtimi fillestar i modeleve të kalave duke ndërthurur materiale të thjeshta dhe të riciklueshme për realizimin e elementeve kryesor.
- Prezantimi i produktit 3D të kalave dhe diskutimi mbi rëndësinë historike dhe arkitekturën e kalave.

Përshkrimi i produktit të projektit:

- **Modeli i kalasë:** Secili grup do të krijojë një model 3D të një prej kalave shqiptare, duke paraqitur elementet kryesore të arkitekturës dhe funksionet e saj.
- **Prezantim:** Çdo grup prezanton projektin sipas paracaktimit të ndarjes së punëve brenda grupit duke shpjeguar funksionin, historinë dhe arkitekturën e kalasë.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- **Aftësitë kërkimore/hulumtuese:** Përfshirja e nxënësve në hulumtim, skicim dhe ndërtim të modelit 3D.
- **Aftësitë e prezantimit:** Vlerësimi i cilësisë së modelit 3D, saktësia historike, kreativiteti i përzgjedhjes së materialeve në realizim.
- **Mendimi kritik dhe reflektimi:** Diskutim mbi atë çfarë është mësuar dhe se si struktura e kalave ka ndikuar në zhvillimin e historisë shqiptare.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave, fakteve, ngjarjeve etj.	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë përdorin teknika të	Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika të	Nxënësit zakonisht përdorin teknika të	Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të përshtatshme dhe

Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre.</i> <i>Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

